



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 116 prot.

Fushë-Arrëz, më 15. 01. 2025

NJOFTIM

PËR MBLEDHJE TË KËSHILLIT TË BASHKISË DHE KOMISIONEVE TË PËRHERSHME

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz:

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, si dhe Rregullores për funksionimin e Këshillit të Bashkisë, në bazë të mbledhjes së Kryesisë së Këshillit të datës 14. 01. 2025, njoftoheni se mbledhja radhës e Këshillit të Bashkisë për muajin Janar 2025 zhvillohet, **ditën e hënë, datë 27.01.2025, ora 10:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak me rend dite:**

1. Miratimi i Projektvendimit për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Dhjetor 2024.
2. Miratimi i Kritereve për dhënien e Ndihmës Ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit,
3. Miratimi i Projektvendimit për Planin e Integritetit të Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën 2025-2027.
4. Miratimi i projektvendimit për listën emërore të përfituesve të subvencionimit me qira.
5. Miratimi i projektvendimit për shumën e bashkëfinancimit subvencionimit me qira.
6. Miratimi i projektvendimit për nivelin e qirave për struktura të ndryshme apartamenti.
7. Miratimi i projektvendimit për ngritjen e strukturës për menaxhimin e strehimit social në bashki.
8. Miratimi i projektvendimit për listat emërore të përfituesve për përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara.
9. Rishqyrtimi i vendimeve të kthyera nga Prefektura.
10. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.
11. Të ndryshme.

Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz

email: info@bashkiafushearrez.gov.al

MBLEDHJE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME

- a) Mbledhja e Komisionit të Mirëqenjes Sociale, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut (**Franc Doda, Tereze Dema, Pavlin Qafa**), ditën e **premtë**, datë **24. 01. 2025**, ora **9:00** në sallën e mbledhjeve të Këshillit për pikën **1;2;4;7;8** të rendit të ditës.
- b) Mbledhja e Komisionit të Ekonomisë, Financave, Buxhetit, Mbikqyrjes Financiare, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, (**Franc Doda, Valentin Doçi, Valentina Lleshaj, Besjana Marku, Zef Cara**), ditën e **premtë**, datë **24. 01. 2025**, ora **13:00**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit për pikën **5** të rendit të ditës.
- c) Mbledhja e Komisionit të Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit, Shërbimeve Publike, Transportit, dhe Strehimit (**Afrim Ndoj, Mustaf Pashkaj, Besjana Marku**), ditën e **premtë**, datë **24. 01. 2025**, ora **13:30**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit për pikën **6** të rendit të ditës.
- d) Mbledhja e Komisionit Juridik të Mandateve, Rregullores, Qeverisjes së Mirë, Zgjedhjeve, Administratës dhe Strukturave Komunitare (**Lin Preni, Afrim Ndoj, Vjollca Tabakaj**) ditën e **premtë**, datë **24. 01. 2025**, ora **14:00**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit për pikën **3** të rendit të ditës.

Duke kërkuar korrektësinë tuaj për pjesëmarrjen në mbledhjet e komisioneve dhe mbledhjen plenare të Këshillit të Bashkisë!

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

Në mungesë dhe me porosi

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

